

NEWSLETTER E DIASPORËS

PËRFQËSIMI DHE NËXTJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDRËVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NËXTUR E FUGIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRIË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#17

Miratohet Statusi i Këshillit Koordinues të Diasporës

Tashmë anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës kanë një status të përcaktuar, pasi Këshilli i Ministrave ka miratuar propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën për dhënien e një statusi të veçantë. Sipas këtij vendimi anëtarët e KKD-së do të kenë mundësi kërkimi të informacioneve për fushat përgjegjëse që mbulojnë, mund të propozojnë akte administrative pranë institucioneve shtetërore që lidhen me Diasporën shqiptare.

Si dhe mund të marrin pjesë në seancat dëgjimore në Komitetin Shtetëror të Diasporës ose komisionet e Kuvendit të Shqipërisë për çështjet që kanë të bëjnë me interesat e diasporës shqiptare dhe me pajsen me një adresë zyrtare. Pjesë e rëndësishme e misionit të anëtarëve të KKD-së është mbrojtja dhe forcimi i marrëdhënieve ndërmjet vendit të origjinës dhe Diasporës.

Më poshtë mund të lexoni vendimin e plotë:

[VENDIM PËR STATUSEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOORDINUES TË DIASPORËS](#)



Miratohet financimi i projektit "Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë"

Këshilli i Ministrave ka miratuar propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën për financimin e projektit "Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë" dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Bazuar në nenin 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", dhe të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr.32/2018, "Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës" Këshilli i ministrave vendosi financimin e projektit për 30 (tridhjetë) muaj, me buxhet prej 40, 984.477 (dyzet milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katërtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

Ky fond do të përdoret për realizimin e aktiviteteve si: organizimin e konferencave / forumeve vjetore të Diasporës, mbështetje për organizimin e forumeve të Grave të Diasporës shkencore, shkëmbimin shkencor nëpërmjet transferimit të dijeve, publikimin e Panimeve të Diasporës Shkencore, si dhe informimin nëpërmjet kanaleve të komunikimit. Projekti "Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë" dhe Zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës" lindi si rezultat i Samitit të Dytë të Diasporës, qëlim i tij është angazhimi i Diasporës shkencore shqiptare dhe profesionistëve të kualifikuar, përmes zbatimit të strategjive kombëtare, me qëllim generimin e transformimeve ekonomike dhe sociale në Shqipëri.

Vendimi e plotë mund të lexoni në link-un e mëposhtëm:
<https://diaspora.gov.al/miratohet-financimi-i-projektit-diaspora-shkencore-si-nje-faktor-ndryshimi-ne-procesin-e-integrimit-evropian-te-shqiperise/>



Fondi Shqiptar i Zhvillimit për Diasporën dhe Instituti "AlbShkenca" organizojnë takimin ndërkombëtar "Kërkimi Shkencor në Hapësirën Mbarë shqiptare dhe Roli i Diasporës Shkencore"

Fondi Shqiptar i Zhvillimit për Diasporën dhe Instituti "AlbShkenca" nën kujdesin e Ministrit të Shtetit për Diasporën, organizojnë takimin e 14-të ndërkombëtar "Kërkimi Shkencor në Hapësirën Mbarëshqiptare dhe Roli i Diasporës Shkencore". Ky event, i cili pritet të mbledhë kërkues shkencorë dhe studiues shqiptarë nga mbarë bota do të mbahet në Tiranë, në shtator 2019. FSHZHD dhe AlbShkenca, në këtë takim do të marrin pjesë studiues të të gjitha disiplinave nga rajoni dhe Diaspora, të cilët janë pjesë e strukturave akademike shqiptare, kërkues shkencorë të pavarur, shkencëtarë të huaj të lidhur ose jo me trojet shqiptare.

Qëllimi i këtij takimi shkencor ndërkombëtar është lehtësimi i komunikimit të ndërsjelltë mes kërkuesve shqiptarë me qëllim mundësimin e koordinimit shkencor më të mirë të mundshëm në territoret shqiptare, me Diasporë shkencore më të përparuar. Ky takim do të jetë një hapësirë për të paraqitur arsyet më të reja të studiuesve në fushat përkatëse të ekspertizës.



Pjesëmarrje historike e kandidatëve shqiptarë në zgjedhjet në Itali. Një shprehje e integrimit të komunitetit shqiptar në shoqërinë italiane. Zgjedhjet administrative italiane do të mbahen më 26 maj, në të njëjtën kohë me zgjedhjet europiane. Numri i kandidatëve shqiptarë që garojnë në 12 rajone të Italisë.

Të gjithë emrat e kandidatëve shqiptarë mund të gjeni këtu:

<https://sq.albanianews.it/itali/kandidate-shqiptare>

FSHZHD shpall vende të lira pune, në kuadër të projektit "Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë"

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në kuadër të projektit "Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë" shpall vendet e lira të punës për pozicionet e mëposhtme:



-Drejtor i Drejtorisë së Projekteve dhe Mbeshtetjes së Sipërmarrjes për Diasporën.

-Katër Specialistë për Sektorin e Projekteve dhe Mbeshtetjes së Sipërmarrjes për Diasporën.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve, do të bëhet në zyrën e protokollit të FSHZHD-së pranë Kryeministrit si dhe në e-mailin zyrtar të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës: info@adf.al. Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve është: data 24.05.2019 ora 16.00.

Për të gjithë të interesuarit pozicionet e lira dhe kriteret e aplikimit mund të gjeni në link-un e mëposhtëm:

<https://diaspora.gov.al/fshzhd-shpall-vende-te-lira-pune-ne-kuader-te-projektit-diaspora-shkencore-si-nje-faktor-ndryshimi-ne-procesin-e-integrimit-evropian-te-shqiperise/>